



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 171/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Ymer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Vesna Jovanovic, në cilësinë e kandidates për kryetare të Komunës së Parteshit, nga Iniciativa Qytetare Zajedno Za Opstanak (GIZZO), paraqitur kundër Milosh Stojkovic nga fshati Pasjan, në cilësinë e bartësit të listës nga i njëjti subjekt politik, në seancën e panelit të mbajtur me 09 Qershor 2010, mori këtë:

V E N D I M

Apeli refuzohet si i pabazuar.

A R S Y E T I M I

Vesna Jovanovic, në cilësinë e kandidates për kryetare të Komunës së Parteshit, nga Iniciativa Qytetare Zajedno Za Opstanak (GIZZO), ka parashtruar apel me të cilën pretendon se Milosh Stojkovic nga fshati Pasjan, në cilësinë e bartësit të listës nga i njëjti subjekt politik, është duke i shkaktuar dëm të madh këtij subjekti politik ngase ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga lista e këtij subjekti politik, parashtruesi i apelit thekson se bartësi i listës së këtij subjekti politik ka filluar të punoj kundër interesave të subjektit politik që ai është bartësi listës, kështu që është aktivizuar në fushatën kundër kandidates për kryetare të Komunës së Parteshit, nga subjekt politik GIZZO.

Parashtruesi i apelit, kërkon nga KZAP-i, që të bëjë të mundur largimin nga lista e kandidatit Milosh Stojkovic, në cilësinë e bartësit të listës nga subjekti politik GIZZO, sipas parashtruesit të apelit kjo është e vetmja mënyrë përmes se cilës zgjedhjet në Komunën e Parteshit të jenë fer dhe korrekte.

F A K T E T

Më 21 maj 2010, KZAP-i, ka pranuar një apel nga Vesna Jovanovic, në cilësinë e kandidates për kryetare të Komunës së Parteshit, nga Iniciativa Qytetare Zajedno Za Opstanak (GIZZO), me të cilën pretendon se Milosh Stojkovic nga fshati Pasjan, në cilësinë e bartësit të listës nga i njëjti subjekt politik, është duke i shkaktuar dëm të madh këtij subjekti politik ngase ka paraqitur kërkesë për tërheqje nga lista e këtij subjekti politik, parashtruesi i apelit thekson se bartësi i listës së këtij subjekti politik ka filluar të punoj kundër interesave të subjektit politik që ai është bartësi listës, kështu që është aktivizuar në fushatën kundër kandidates për kryetare të Komunës së Parteshit, nga subjekt politik GIZZO.

Parashtruesi i apelit, ia ka bashkangjitur apelit deklaratat: Zivorad Jovanovic, Milosh Stojkovic dhe Bojan Cvetkovic.

KZAP-i, më 28.05.2010, kërkoj nga ZRPPC-ja, Formularin për Certifikimin e Kandidatëve, më të cilën vërtetohet se kandidati Milosh Stojkovic nga fshati Pasjan, ka nënshkruar me vetëdëshirë Formularin për Certifikimin e Kandidatëve, më datë 21.04.2010.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Tërheqja apo Zëvendësimi i Kandidatëve dhe Subjekteve Politike

Dispozita e nenit 28 paragrafi 2 i LZP-së përcakton se:

Në rast se KZAP-i largon një kandidat nga lista e kandidatëve pas përcaktimit se kandidati nuk ka dhënë pëlqimin e tij apo saj për t'u emëruar si kandidat, subjekti politik nuk mund të zëvendësojë atë kandidat në listën e kandidatëve, por siguron që lista të jetë në përputhje me nenin 27 të këtij ligji.

KZAP-i, konstaton se Apeli është i pabazuar për faktin se nuk përmban rrethana të atilla të cilat do të ndikonin në largimin e personit të lartë cekur nga bartësi i listës të subjektit politik GIZZO, siç figuron nga shkresat e lëndës, sepse personi në fjalë me vetëdëshirë e ka nënshkruar Formularin për Certifikimin e Kandidatëve më datë 21.04.2010.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 171/2010 më datën 09.06.2010.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

